

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje me gjyqtarin Agim Maliqi, kryetar i trupit gjykues dhe me gjyqtarët profesionistë Hakile Ilazi dhe Ilir Bytyqi, anëtar, si dhe me sekretaren juridike Qëndresa Bobi, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.R., për shkak të veprës penale grabitja në tentativë nga neni 329 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, PP.I nr.163/14 të datës 13.03.2015, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Florije Salihu – Shamolli, të akuzuarit B.R., mbrojtësi i tij me autorizim av. B.S., pas mbajtjes së shqyrtimit të hapur gjyqësor me datat 21/22.07.2015, me 23.07.2015 mori dhe publikisht shpalli, kurse me dt.27.07.2015 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B.R., nga i ati Z. dhe e ëma H. e gjinisë A., data e lindjes.....në Ferizaj, me vendbanim në lagjen “”- Shtime, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i pa punë, i pa martuar, din shkrim lexim, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, mbrohet në liri.

Në bazë të nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPP-së

LIROHET NGA AKUZA

Se me date 21 qershor 2014 rreth orës 13:05 ne filalin e që gjendet në rrugën “ 12 Qershori” në Shtime, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të personit tjetër, me anë të kanosjes serioze duke përdorur sprejin në drejtim të saj se do të sulmojë jetën dhe trupin e të dëmtuarës E.R., ka tentuar të bëjë grabitjen, në atë mënyrë që fillimisht ka kërkuar të hollat pastaj ka provuar të hapë derën e cila ndan banakun ku janë paratë nga pjesa tjetër e hapësirës në lokal, meqenëse dera ishte e mbyllur i pandehuri nuk ka

mundur të depërtoj pastaj viktima ka thirrur për ndihmë dhe ka shtypur butonin sinjalizues pastaj i pandehuri është larguar në drejtim të panjohur.

- meqë nuk është provuar që ka kryer veprën penale grabitja në tentativë nga neni 329 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

E dëmtuara E.R. nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Shpenzimet bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m i

1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzën të evidentuar PP.I nr. 163/14 të datës 13.03.2015, ndaj të akuzuarit B.R., për shkak të veprës penale grabitja në tentativë nga neni 329 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 21.04.2015, kurse i akuzuari u deklarua i pafajshëm përkitazi me aktakuzën, ashtu që, Gjykata vazhdoi me shqyrtimin gjyqësor me datat 21/22 dhe 23.07.2015, kurse përfaqësuesi i akuzës - Prokurori i Shtetit Florije Salihu Shamolli, në fjalën e saj përfundimtare mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar Gjykatës, që i akuzuari B.R., të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënimi për veprës penale grabitja në tentativë nga neni 329 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

2. Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari B.R., në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon akuza dhe më pas në mbrojtjen e tij ka deklaruar se në ditën kritike ka qenë në shtëpinë e tij, kurse përkitazi me ngjarjen ka kuptuar ditën e njëjtë pasi që ka dal në qytetin e Shtimes gjatë bisedave me shokët e tij në dhe aty ka dëgjuar se ishte thyer Më tutje në mbrojtjen e tij ka mohuar kryerjen e kësaj vepre penale duke shtuar faktin se siç ka deklaruar edhe në seancat tjera nuk e ka kryer këtë vepër penale.

3. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që i akuzuari, nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale që e ngarkon aktakuza e Prokurorit të shtetit, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe gjatë procedurës hetimore;
- përmes dëshmisë së dëshmitares- të dëmtuarës E.R.;
- përmes dëshmisë së dëshmitarit G.P.;
- përmes video incizimit të CD-së nga kamerat e sigurisë në filialin e
-
- përmes fotografive dhe raportit të vendit të ngjarjes i datës 21.06.2014.

4.Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Para vlerësimit të provave të prezantuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, fillimisht Gjykata vlerëson si të vërtetuara dhe të pakontestueshme faktet si në vijim:

- se me datë 21.06.2014, rreth orës 13:05 në zyrën e;
- ndodhi një tentativë për grabitje;
- ngjarja u në Shtime në rrugën kryesore përkatësisht “12 qershori”;
- tentativa e grabitjes u pa qartazi se një person fillimisht hynë dhe pas hyrjes ka tentuar që ta hapë derën e banakut;
- dhe pasi që nuk arrin ta hapë derën e banakut largohet me një shpejtësi duke vrapuar në rrugën kryesore në drejtim të Ferizaj.

Faktet që u potencuan më lartë, paraqesin anën objektive të veprës penale, andaj Gjykata në këtë shqyrtim gjyqësor është përqendruar në vërtetimin e anës subjektive të veprës penale nga shkakut se enigmatike ka qenë pikërisht kjo komponentë përkatësisht dilemë ka qenë vërtetimi i faktit se cili ishte personi që kreu veprën penale, andaj rrjedhimisht pjesa më e madhe e shqyrtimit gjyqësor e natyrshëm edhe e arsyetimit të këtij aktgjykimi do të jetë e përqendruar pikërisht në trajtimin e këtij aspekti.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit E.R., është vërtetuar fakti se me datën 21.06.2014, ka qenë duke punuar ne vendin e saj te punës në zyrat e- filiala në Shtime rruga “ 12 Qershori”, në pozitën e agjentit të shitjes, dikur rreth orës 13:00 e disa minuta ka hyrë një person i cili kishte të veshura pantallona të gjelbër, një dukës me kapele të cilën kapel e kishte të vendosur në kokë dhe kishte të vendosura syze te zeza dielli, i cili fillimisht nuk ka folur asgjë dhe të njëjtin e kishte pyetur rreth kërkesës së tij ashtu siç vepron me çdo klient tjetër, por i njëjti kishte qëndruar edhe pak ashtu pastaj e ka nxjerr sprejin nga xhepi dhe ka thënë “ qiti paret”, dhe menjëherë sprejin e ka hedhur ne drejtim timin përkatësisht gazin e sprejit dhe atë në fytyrë , dhe menjëherë ka filluar djegia e syve dhe për një moment dëshmitarja nuk ka parë asgjë, pastaj i njëjti ka tentuar ta hap derën e banakut por nuk ka arritur ta hap meqë ishte e mbyllur më qelës ashtu që personi ka ikur nga aty.

Më tutje dëshmitarja e pyetur rreth identitetit te personit qe kishte hyre ne, sqaron “ afërsia mes meje dhe këtij personi qe ka hyrë ne ka qenë shumë e afërt, vetëm na ka ndarë banaku i vendosur në zyrë, unë këtë person asnjëherë në jetën time paraprakisht nuk e kam parë dhe përveç gjerave personale qe i ka pasur të veshura (duksin me kapelë dhe syzet) , unë nuk e kam parë qe i njëjti se çka ka pasur të mbathur ditën kritike” e për me tepër e njëjta edhe pas shikimit në fotografinë e nxjerrur nga incizimi ka pohuar se pikërisht i akuzuari ka qenë personi që kishte hyrë në zyrën e-it”

Nga fakti se dëshmia e dëshmitares E.R., e cila ishte dëshmitarja kryesore e kësaj çështje penale përkatësisht bazuar në dëshminë e saj është ndërtuar skeleti i kësaj aktakuze, andaj për këtë arsye me rastin e vlerësimit të dëshmisë së kësaj dëshmitare, Gjykata u tregua maksimalisht e kujdesshme dhe fillimisht dëshmia e saj duhet të ndahet në dy pjesë:

- *pjesa e parë i referohet dëshmisë së saj për ngjarjen e ndodhur, e që në këtë pjesë është e qartë se bëhet fjalë për një dëshmitare të sinqertë dhe të ndershme për më tepër kjo pjesë e dëshmisë së saj është tërësisht e besueshme për faktet objektive (hyrja e personit në zyre, ofrimi i tij afër banakut tentimi i hapjes së derës së banakut dhe largimi i tij) dhe se kjo dëshmi është në harmoni të plotë me incizimet e CD-së;*

- *por e diskutueshme dhe padyshim e rëndësishme është pjesa tjetër e dëshmisë së dëshmitares që ka të bëjë me identifikimin e personit, gjithsesi kjo çështje duhet trajtuar në mënyrë kronologjike pra në të gjitha fazat e dëshmisë së saj dhe e rëndësishme është të*

potencohet paraprakisht fakti se në rastet e identifikimit mundësia e gabimeve edhe tek dëshmitarët më të saktë, më të vëmendshëm dhe më të sigurt është mjaft e madhe dhe posaçërisht duke e marrë parasysh faktin se identifikimi paraqet provën vendimtare :

- padyshim se në fillim të dëgjimit të dëshmitares e njëjta as që kishte idenë për personin që hyri në zyre as pamjen e tij dhe as tiparet e tij, por u përqendrua vetëm në veshjen e tij “... e kam parë personin i cili ka hyrë ne, i cili kishte syza te diellit dhe një duks ngjyrë krem me kapelë e cili e kishte kapelën e duksit në kokë...”¹ përkatësisht duke vazhduar me dëshminë e saj se “...personi i dyshuar ka pasur një duks të vjetruar të cilin e kishte vu në kokë, një palë syze të diellit dhe më shumë nuk më kujtohet mirëpo për çdo rast kemi edhe kamerat ku kanë bërë incizimin...”², e që kjo është tërësisht e kuptueshme për faktin e ngjarjes traumatike që përjetoi dëshmitarja në rend të parë frika dhe shqetësimi vetëm disa orë pas ngjarjes të rikujtojmë se ngjarja ndodhi në ora 13:05 kurse dëshmia e saj u morr në ora 15:15.

- e gjithashtu edhe gjatë dëshmisë së saj vijuese me dt.23.06.2014, dëshmitarja përsëriti vetëm përshkrimin e veshjeve të të akuzuarit dhe nuk paraqiti asnjë element përkitazi me tiparet e të akuzuarit “... ka ardhur një person me syze dielli dhe me një duks me kapelë të vendosur në kokë dhe është futur në zyrë”³, e që në fakt edhe gjatë kësaj dëshmie e njëjta nuk dha ndonjë informacion më konkret përkitazi me dukjen e të pandehurit pos faktit se ishte i moshës rreth 20 vjet.

- dhe tek në dëshminë e tretë të saj të datës 25.06.2014, kur është përpiluar një procesverbal që për Gjykatën është i paqartë se a ishte procesverbal i marrjes në pyetje të dëshmitares (siç emërtohet nga ana e zyrtarëve policor) apo procesverbal për identifikim dhe pasi bëri një shikim në disa persona atëherë pohoi faktin se “...personi që e pash i ngjante shumë personit i cili ka hyrë atë ditë për të më grabitur si në të ecur i drejt dh i thatë në fytyrë dhe nga ajo dite më ka mbetur në kujtesë mjekra e tij dhe pjesa e gojës sepse ka qenë pa maskë vetëm syza dhe kapelën e duksit...”⁴ dhe u përcaktua për tani të akuzuarin dhe tani këtu paraqitet një pyetje e logjikshme se në fakt çka nënkuptonte kjo a ishte procedurë e identifikimit (meqë është e qartë se identifikimi nuk është bazuar në procedurat standarde të

¹ Pjesë e deklaramit të dëshmitares e dhene ne procesverbalin e dates 21.06.2014

² Po aty si ne fusnotën 1

³ Pjesë e deklaramit të dëshmitares e dhene ne procesverbalin e dates 23.06.2014

⁴ Pjesë e deklaramit të dëshmitares e dhene ne procesverbalin e dates 25.06.2014

identifikimit, konform dispozitës përkatëse të nenit 120 të KPP-së të renditen së paku 8 persona me pamje të ngjashme e pastaj këta persona të fotografohen dhe këto fotografi të jenë në dispozicion të gjykatës me qëllim të paraqitjes si provë), e gjithashtu në ndërlidhje të kësaj po ashtu është interesant fakti se cila ishte arsyeja që nga dëshmitarja paraprakisht nuk ishte kërkuar që të përshkruante të akuzuarin dhe pastaj të fillonte procedura e identifikimit.

Gjithashtu përveç këtyre kundërthënieve që u ceken nga ana e dëshmitares gjatë procedurës hetimore, e njëjta vazhdoi me kundërthënie edhe gjatë paraqitjes së dëshmisë së saj gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe atë :

- dëshmitarja gjatë shqyrtimit gjyqësor ishte mjaft konfuzë dhe e paqartë deri sa në hetime pohon se kanë qenë 5 persona për identifikimin në shqyrtimin gjyqësor pohon se kanë qenë 3 persona;

- për të vazhduar me konfuzitetin e saj edhe në shqyrtimin gjyqësor në faktet tjera se mes të personave të renditur ishte i akuzuari si dhe një person tjetër i panjohur e që këtë fakt fare nuk e ka përmendur gjatë procedurës hetimore.

Në fakt duhet përmendur edhe disa faktorë që ishin determinant me rastin e shikimit të personave dhe se ky shikim ishte jo i saktë dhe atë:

- së pari faktori kohë meqë bëhet fjalë për një kohë mjaft të shkurtër prej hyrjes deri te dalja vetëm 12 sekonda;

- gjithsesi në këtë kohë të shkurtër ndikoi edhe faktori tjetër se një pjesë e kësaj kohe kaloi me pamje jo të mirë të dëshmitares nga fakti se asaj iu hodh gazi në sy që pamundësoi pamjen;

- po ashtu faktori i tretë i rëndësishëm është fakti se personi që hyri në zyre ishte i përgatitur paraprakisht dhe se ishte kamufluar me kapelë të duksit në kokë dhe syze të diellit;

- cilësia e incizimit nuk ishte e kualitetit të lartë e realizuar përmes incizimit pa ngjyrë;

- dhe përfundimisht faktori tjetër është edhe fakti siç pohoi vet dëshmitarja se personin për herë të parë e ka parë atë ditë e që do të ishte tërësisht ndryshe po ta kishte parë më parë;

Dëshmitari G.P., gjatë dëshmisë së tij ka vërtetuar faktin se me të akuzuarin janë njohur edhe më herët, për të vazhduar se dëshminë e ka paraqitur pasi ka bërë shikimin në incizimin e CD të datës 21.06.2014, duke theksuar se bazuar në këtë shikim të incizimit nuk ishte i sigurtë se personi në incizim ishte i akuzuari por se bazuar në patikat e personit ai mund të jetë i akuzuari pasi që me të akuzuarin më herët kanë qenë shok dhe se ka qenë prezent në momentin kur B. përndryshe kushëri i të akuzuarit i ka sjell një palë puma e për të cilat puma kanë qenë me ngjyrë të zezë dhe vija të bardha, e që bazuar pikërisht në këto puma ka pohuar faktin se B.R. mund të jetë personi që ka parë në incizim, për më tepër ka shtuar faktin se në bazë të informacioneve që dëshmitari posedonte se fillimisht tani i akuzuari B.R. kishte pohuar në polici se kryes i kësaj vepre penale ishte dëshmitari dhe kjo ishte komunikuar dëshmitarit gjatë intervistimit nga ana e policeve hetues se kinse ky kishte kryer këtë vepër penale.

Vlerësimin e dëshmisë së këtij dëshmitari, Gjykata e bëri me kujdës maksimal dhe atë për disa arsye:

- së pari dëshmitari nuk ishte dëshmitar okular i vendit të ngjarjes;
- dëshmia e tij ishte produkt i faktit se dëshmitarit së pari iu prezantua incizimi nga CD-ja e më pastaj u kërkua nga ai identifikimi bazuar në këtë incizim;
- është posaçërisht i rëndësishëm fakti se dëshmia e tij zë fill nga fakti se pikërisht i akuzuari (B.R.) sipas zyrtarëve hetues kishte dashur që kryerjen e kësaj vepre penale t'ia atribonte dëshmitarit e për më tepër kishte një dozë dyshimi se dëshmitari ishte në mesin e personave të dyshuar;
- dhe përfundimisht edhe vet metoda e identifikimit të bërë nga dëshmitari përmes incizimit është mjaft e pa logjikshme dhe e panatyrshme, meqë identifikimin e ka bërë në bazë të të mbathurave – pumave të të “ akuzuarit” e që më së miri demantohet përmes vet pjesës tjetër të dëshmisë së tij “... pasi e kam shikuar CD se ky është B.R., tjetër karakteristikë un nuk kam vërejtur tek ai e po shtoj faktin se B. B.R. ia ka dhënë pumat 3-4 muaj para se unë ta shikoj CD-në, në polici...”⁵, që paraqet diçka mjaft interesante se dëshmitari të mbaj mend pikërisht pumat e të akuzuarit dhe atë pas një periudhe mjaft të gjatë kohore.

⁵ Shih procesverbalin e dates 22.07.2015, faqe 9

Andaj bazuar në faktorët e lartcekur Gjykata vlerëson se dëshmitari nuk paraqiti dëshmi objektive dhe të saktë, përkundrazi pjesa më e madhe e dëshmisë së tij ishte jo relevante kurse një pjesë e dëshmisë së tij e ndikuar nga efekti i kundërveprimit si pasojë e faktit se kishte dëgjuar se i akuzuari kishte inkriminuar pikërisht atë si kryerës të veprës penale.

Sa i përket fotoalbumit të vendit të ngjarjes, aty shihen fotografitë e-, dhe atë pjesa e jashtme dhe e brendshme e zyrës, e po ashtu vërehet se një person i veshur me një duks dhe me kapelë të duksit në kokë dhe me syza, hyn në lokal me duar në xhepa dhe del duke vrapuar, kurse nga shikimi në video incizimet e CD-së, e cila është e ndarë në tre pjesë e ashtu që pjesa e parë është incizim nga kamera e jashtme ku shihet një person i cili në mënyrë të qetë hynë në lokal dhe pas disa sekondave përkatësisht 12 sekondave i njëjti person me vrap del nga lokali dhe vazhdon ikjen në anën e djathtë, për më tepër personi kishte te vendosura syzet e diellit dhe një duks me kapelë, kapelën e kishte vendosur në kokë.

Gjithashtu edhe në pjesën e dytë të CD-së, që është incizim nga kamera e brendshme e lokalit, ku shihet personi i cili hyn, e që pamja është mjaft errësirë dhe që fare nuk shihet fytyra e personit kurse nuk shihen veprimet tjera, por shihet tentimi për hapjen e derës së shankut, po ashtu shikimi i pjesës së tretë të CD-së, i cili është incizim nga kamera e jashtme me ç'rast shihet personi me duks dhe kapelën e duksit në kokë duke ikur nga lokali, e që nga ky incizim fare nuk shihet fytyra e personit.

Gjykata vlerëson se incizimet e CD-së, nuk ishin imazhe edhe aq të qarta e edhe më të vështirë shikimin e bën fakti se personi kishte të veshur një duks me kapelë në kokë dhe syze të diellit me ngjyrë të errët dhe kjo paraqiste vështirësi shtesë meqë nuk ishte i dallueshëm asnjë tipar i fytyrës e gjithë këto të dhëna duke i ndërlidhur me aspektin kohor se ngjarja ishte zhvilluar për një kohë shumë të shkurtër përkatësisht 12 sekonda duke filluar në ora 12:29:10, me hyrjen e personit në zyre dhe përfundon me 12:29:22, me daljen e personit nga zyra, andaj kjo e bën mjaft të vështirë për Gjykatën përcaktimin e faktit vendimtar se personi në incizim a ishte i akuzuari e që gjithsesi kjo dilemë nuk u eliminua edhe përkundër faktit se shikimi në incizim u bë disa herë dhe duke u krahasuar me pamjen e drejtpërdrejt të të akuzuarit e megjithatë nuk rezulton se i akuzuari ishte personi që paraqitet në këtë incizim.

5. Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit

Gjithsesi për të bërë një analizë të gjitha provave të shqyrtimit gjyqësor është e nevojshme të vlerësohet edhe mbrojtja e të akuzuarit e cila natyrisht asnjëherë nuk duhet të vlerësohet në mënyrë fragmentare nga provat tjera, të rikujtojmë se i akuzuari gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor ka mohuar kryerjen e kësaj vepre penale, por se natyrshëm në rastet e tilla kur bëhet fjalë për një vepër të kësaj natyre tejet të rëndë është plotësisht e pabesueshme që nga i akuzuari të arrihet diçka më tepër rreth shtjellimit të kësaj çështje.

Në vlerësim të mbrojtjes së të akuzuarit gjithsesi është e rëndësishme që të përmenden disa karakteristika:

- së pari i akuzuari që nga faza fillestare e mbrojtjes e deri në përfundim të saj ka mohuar kryerjen e kësaj vepre penale;
- ka qenë konsistent dhe asnjëherë nuk ka ndryshuar mbrojtjen e tij;
- ka përshkruar mënyrën se si ka kuptuar për ngjarjen diku pas një intervali të shkurtër kohor pas ngjarjes dhe atë pasi ka dalë në afërsi të vendit ku ndodhet zyra et;
- paraqitën mbrojtje të logjikshme, të natyrshme, për më tepër mbrojtja e tij është në harmoni dhe e mbështetur me provat tjera të prezantuara;

7. Analiza e fjalës përfundimtare të Prokurorit të Shtetit

Analiza e fjalës përfundimtare të Prokurorit të Shtetit e paraqitur në shqyrtimin gjyqësor fillimisht ka ngjarjen e ndodhur në ditën kritike, sipas variantit së të dëmtuarës duke u përqendruar posaçërisht në dëshminë e dëshmitares – dëmtuarës se në sallë të gjykimit e njëjta ka pohuar se tani i akuzuari është kryes i veprës penale.

Prokurori i Shtetit në thelb nuk ka arritur që të paraqes ndonjë provë të themeltë që do të bënte të besueshëm se i akuzuari është kryes i kësaj vepre penale, për më tepër edhe vet përshkrimi i saj në fjalën përfundimtare është përshkrim tejet i thjeshtë pa paraqitur asnjë detaj dhe lidhshmëri mes provave të prezantuara dhe duke e përfunduar me zhargonin e zakonshëm përkatësisht duke kërkuar nga Gjykata të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, por shumica e pretendimeve të tij kanë mbetur në suaza të supozimeve, pa arritur që ta tejkalojnë kufirin e dyshimit të arsyeshëm, për më tepër janë përshkruar të gjitha dëshmitë dhe provat tjera materiale dhe duke u përshkruar edhe mbrojtja e të akuzuarit, e që në fakt të

gjitha këto prova në fakt kanë vërtetuar fakte të pakontestueshme (*se një person ka hyrë në filialin e-it në Shtime, fillimisht ka kërkuar para dhe më vonë ka hedhur materien e gaztë nga spreji dhe e dëmtuara është alivanosur*) e po ashtu edhe fakte të natyrës objektive meqë këto fakte të përmendura padyshim se kanë ndodhur, por e pasqaruar dhe e pavërtetuar ka mbetur aspekti subjektiv se a ishte i akuzuari kryes i kësaj vepre penale e që bazuar në provat e paraqitura nuk është tejkaluar as dyshimi i bazuar se i akuzuari ishte kryesi i kësaj vepre penale.

Në ndërlidhje me fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit duhet analizuar edhe përshkrimin e aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i cili përshkrim është mjaft i përgjithësuar pa asnjë lidhje as të elementeve esenciale të veprimeve të tij siç është mënyra e kryerjes se veprës penale por ti analizojmë më hollësisht disa nga këto pretendime:

- së pari – deri sa në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit, ka përshkruar se pas hedhjes se sprejit e dëmtuara – dëshmitarja është alivanosur e që këtë fakt fare nuk e përshkruan në dispozitivin e aktakuzës, e që praktikisht nëse do ishte i saktë pretendimi i prokurorit të shtetit se e dëmtuara ishte alivanosur kjo e bën të dukshëm të vështirësuar për të mos thënë të pamundur identifikimin e personit që kreu veprën penale, e këtë fakt duke e ndërlidhur edhe me kohën e shkurtë të ngjarjes së zhvilluar që sipas incizimeve ishte vetëm 12 sekonda.

Në vazhden e analizës së fjalës përfundimtare të Prokurorit të Shtetit, posaçërisht potencohet fakti i identifikimit që dëshmitarja i bën të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe kjo është e mjaftueshme.

Por Gjykata vlerëson se identifikimi në sallën e gjyqimit siç u veprua në shqyrtimin gjyqësor, nuk paraqet identifikim sipas dispozitave të KPP-së dhe natyrshëm dëshmitarët janë të prirur që gjithmonë të përcaktohen pozitivisht për të akuzuarin në rastet kur i akuzuari gjendet në gjykatore, për më tepër kjo formë e identifikimit pa përshkrim paraprak është i papërshtatshëm dhe prejudikues dhe se mundësia e gabimeve është tejet e lartë edhe tek dëshmitarët mjaft të besueshëm.

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe dis favor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. E në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “*in peius*” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reason able doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë “*in favorem*” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

8.Kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale

Bazuar në dispozitën e nenit 463 par.2 të KPP-së, e dëmtuara E.R. nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Bazuar në dispozitën e nenit 450 dhe 453 të KPP-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve të kësaj Gjykate.

Gjykata bazuar në provat e prezantuara ka konstatuar se nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën në fjalë, andaj nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me PKR.nr.62/15

**Sekretarja juridike,
Qëndresa Bobi**

**Kryetari i trupit gjykues,
Agim MALIQI**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.

